

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Shoqëria “D I A N I” shpk

Adresa: Kraste- Martanesh, bashkia Bulqizë

Tel: 0682351655

RAPORT PARAPRAK VLERSIMI NDIKIMIT NE MJEDIS

AKTIVITETI I NXJERRJES SE MINERALIT TE KROMIT

OBJEKTI “ GALERITE NR 11,23 V.BURIMI KORMIT

THEKEN” NJESIA MARTANESH BASHKIA BULQIZE

QARKU DIBER

2. Industri nxjerrëse.

2.1 Gurore, miniera sipërfaqësore dhe nxjerrje e torfës (projekte që nuk janë përfshirë në shtojcën I);

2.2 Minierat nëntokësore;



Kraste 28/07/2017

PERMBAJTJA

- a- Pershkrim i biodiversitetit**
- b- Pershkrimi i cilesis se mjedisit kapacitete e zones etj..**
- c- Informacion lidhur me identifikimin e ndikimeve te mundeshme negativene mjediste projektit,perfshire ndikimet ne biodiversitet ,uji,toke dhe ajer.**
- d- Shtrirja fizike dhe kohezgjatja e ndikimeve .**
- e- Ndikimet pozitive ne mjedis, masat shtese.**
- f- Programi i monitorimit te ndikimit ne mjedis**
- g- Plani i menaxhimit dhe monitorimit mjedisor.**
- h- Konkluzione.,**

a) Pershkrimi i biodiversitetit te zone.

a-1)Gjeografia e zones dhe relievi

Aktiviteti minerar i nxjerrjes se mineralit te kromit ndodhet ne zonen e Martaneshit ne ish minieren e kromit Theken.Ne zonen ku shtrihet miniera terreni eshte pothuajse i cveshur plotesisht. Jane te pranishme disa shkurre dhe delleja e kuqe ndersa bimet e larta (pish,ahu bredhi) zhvillohem sier kesaj miniere.Ne kete zone nuk ka specie me status ose statuse te vecante. Vendi perfaqeson nje terren malor me nje lartesi nga + 1520 deri ne 1650 m mbi nivelin e detit.Per nga pikpamja habitore relievi vendi ku jane te hapura galerite e shfrytezimit(traverbangjet) i perkasin nje zone malore habitat shkembor e cila eshte e cvashur nga bimesia e larte dhe te krijon pershtypjen e nje zone pa bimesi.Tereni eshte malor bie ne drejtim te jugut karakterizohet nga qafat lugjet dhe majat. Rreht 70 % e zones eshte me lartesi mbi 1600 m.Karakteristike e reliefit te kesa zone jane majat e thepisura sidomos ne veri-perendim shume te pjerrta dhe grykat e govatat e mbyllura ne trajte amfitetresh si dhe rrezimet masive te shkembijeve te ciptuar.

a-2) Statusi i zones se studiuar dhe objektivi i projektit.

Miniera nga ana administrative ben pjese ne qarkut te Dibres, ajo gjeografikisht eshte pjese e zones e Bater- Theken si zone krom mbajtese, ku jane hapur shume sektore e galeri per shfrytezimin e mineralit te kromit.Nje nder keto miniera eshte dhe objekti 'Galerite nr.11,23 ne Vburimin e kromit Theken ne komunen Martanesh

Punimet ne Theken kane filluar shume vite me pare, rreth viteve 50-60 te shekullit te kaluar, ne ate kohe Thekna ka qene sektor i minieres Bulqize. Data e sakte e fillimit te punimeve ne Theken daton 20 Prill 1959, kur filloi hapja e Galerise Nr 1.

Me vone ne Theken filluan te hapen dhe galeri te tjera, hapja e te cilave ka vazhduar deri ne vitet 80. Galerite nr.11,23 Theken eshte hapur ne fillim te viteve 60-70 te shekullit te kaluar. Zona ku eshte hapur miniera nuk eshte pjese e parkut kornbetar apo e mbrojtur me ligj. Hapja e minicres eshte ne perputhje me planet e zhvillimit ekonomik te vendit dhe nuk cenon aspak statusin dhe karakteristikat e zone.

Kjo zone si nje nga zonat e pasura me minera kromit, ka qene dhe mbetet objekt i studimeve gjeologjike te cilat kane dhene rrezultate mjaft te kenaqshme. Duke vlersuar ketu rrezultate,zona eshte shnderuar ne zone industriale per nxjen e mineralit te kromit.

Qellimi i riaktivizimit ne vitin 1999 dhe vazhdimet te punes ne kete miniere ka qene dhe mbetet shfrytezimi ne menyre optimale dhe komplekse i rezervave te mineralit te kromit.

Shoqeria "DIANI",kerkon standartizimin e lejes mjedisore per veprimtarine e shfrytezimit te rezervave te mineralit te kromit, aktiviteti i cili ushtrohet ne zbatim te Ligjin Nr 10304, date 15.07.200,"Per Sektorin Minerar Shqiptar".

Per rihapje dhe riaktivizimin e minieres jane shfrytezuar studime konkrete,te reja dhe te hershme, studime gjeologjike, minerare,topografike,etj.

Gjithashtu per hartimin e ketij projekti jane shfrytezuar te dhenat e mbledhura dhe te nxjerra gjate periudhes se shfrytezimit nga viti 1999,vit kur ka filluar aktiviteti dhe eshte mare leja mjedisore,aktiviteti i cili vazhdon dhe do te vazhdoje dhe ne te ardhmen.

Per kete qellim subjekti "DIANI" sh.p.k,ka agazhuar grupe specialistesh gjeologe,minerare, ekonomiste,mjedisore dhe topografe te cilet jo vetem se kane hartuar projektin e shfrytezimit, por njekoheisht perbejne stafin drejtus te subjektit.

a-3) Kushtet klimatike.

Zona e Theknes, ne te cilen ben pjese miniera Galerite nr.11,23 Theken karakterizohet nga klima tipike kontinentale;me vere te shkurter,te fresket e me reshje te pakta dhe dimer te gjate,te ftohte e me reshje te bollshme.

Reshjet mesatare vjetore jane rreth 1500 mm. Ne vere ata bien ne forme shiu,shpesh me stuhi,mjaft tipike keto per zonat e thyera malore,me lartesi mbi+ 1000 m;ndersa ne dimer,ata bien ne forme shiu dhe kryesisht debore,trashesia e se ciles,shpesh kalon mbi 50 cm, me rralle deri 1.5 m.

Temperaturat ne vere arrijne deri ne +25-30° C,ndersa ne dimer ato shkojne deri ne -7° C. Per shkak te orientimit lindje-perendim, ne anen veriore,shpati ku vendoset objekti,gjate dimrit,preket shume pak nga rrezet e diellit.

Ererat,qofshin te ftohta apo te ngrohta, per vete pozieionin qe ka kjo zone,nuk e rrahin pothuajse fare objektin.Teper rralle fryn jugu,qe nuk shkakton probleme.

Per shkak te klimes mjaft te ashper e cila shoqerohet me temperatura mjaft te ulta dhe me rreshje te medha bore,ne miniere punohet vetem 9 muajt e viti,nga muai prill deri ne Dhjetor

- Temperaturat ne dimer shkojne deri ne -12°C dhe ne raste te rralla kane arritur dri ne -20°C, ndersa ne vere arrijne deri ne + 25-30 °C Ne anen kundodhet miniera, ana jugore e shpatit rrezet cien mjaftueshem rreth 70% te kohes duke ndikuar ne shkrirjen e bores dhe te akullit dhe temperatura te larta.
- Era fryn kryesiht nga lindja te tipit murlan te ftohtafryjne me intensitet mesatar me shpejtes mesatare nga drejtimi lindor ne ate perendimor.Koj edhe per vete orjentimin qe ka lugina e zallit te Theknes

a-4) Popullsia.

Popullsia ne kete zone po zvogelohote nga viti ne vit per shkak te levizjes drejt qytetetve te medha dhe emigrimit jashte vendit.Zona ku shte hapur miniera paraqitet e varfer lidhur me popullimin.Popullsia perfaqsohet nga zonat me te aferta te banuara te cilat jane Qyteza e Krasta me rreth 1200 banore,dhe fshatrat e komunes Martanesh qe jane rreth qytezes se Krastes.

a-5) Karakteristikat hidrografike.

Rajoni ne studim pamvarsisht se eshte ne kuota mjaft te larta eshte shume i pasur nga ana hidrologjike. Liqenet duke filluar nga me i madhi Liqeni i Zi,per te vazhduar me Liqenin e Sopeve,Liqenin e bardhe dhe disa liqene te tjere me te vegjel ne madhesi jane te shperndare ne gjithe zonen.

Ne lindje dhe veri lindje te objektit kalojne perroi i Sharres,dhe perrenj te tjere te cilet grumbullohen ne perroin Zalli i Batres

Ne drejtimin veri veriperendimor kalojne Perroi Darket,perroi i Theknes,Perroi i Burgut, perroi Vorri i Llahinges te cilet derdhen ne perroin e Theknes, i cili dhe ky buron ne thellesi te zones.

Keto perrenj ne stinen e veres kane shume pak uje, ndersa ne periudhen tjeter te vitit ai eshte i mbushur me uje shiu e bore dhe mjaft i rrembyeshem, per shkak te pjerresise shume te madhe te terrenit ku kalon ky perrua.

Perroskat,ne kohe reshjesh intensive, sjellin me vehte shume materile te ngurta terrigjene,qe shpesh here krijojne llurba te rrezikshme.

Nga kjo rezulton se hidrografia nuk nderlidhet me problemet aktivitetit minerar te shfrytezimit, pasi ajo vendoset larg perroskave dhe burimeve ujore,qe te kene influence ne shfrytezim,apo shfrytezimi te influencoje mbi to.

a-6) Flora dhe fauna e zonës

Bimësia pyjore.

Vend-ndodhja e këtij territori përta i përket lartësisë mbi nivelin e detit ka bërë të mundur zhvillimin e një bimësie të pasur pyjore. Në të hasen zonat fitoklimatike të ahut (fagetum) dhe zona e kullotave alpine (alpinetum), në kufirin e sipërm të vegetacionit. Në këtë zonë gjenden llojet kryesore në arsealin e tyre të përhapjes në kushte të përshtatshme klimatike dhe tokësore zhvillimi si ahu (Fagus sylvatica), pisha e zezë (Pinus nigra), rrobulli (Pinus heldreichi),vërri i zi (Alnusglutinosa),lajthia(Corilusavellana),akacia(Robinia pseudoacacia). Llojet kryesore që cituam më sipër janë të shoqëruara edhe me nënpyll me llojet e tjerë si murrizi (Crataegus monogina), dëllinja (Juniperus oxycedrus), thana (Cornus mas) etj. Përveç llojeve të mësipërme në kushte natyrale gjendet pak i përhapur lisi (Taxus bacata) dhe mështekna (Betula pendula), e cila krahas formës natyrale është e instaluar edhe në rrugë artificiale nëpërmjet pyllëzimeve.

Bimësia barishtore dhe bimët mjekësore.

Kjo zonë është e pasur me bimësi dhe aty takohen një numër i madh bimësh mjekësore dhe barishtore të tilla si:

dëllinja e zezë (Juniperus communis),

dëllinja e kuqe (Juniperus oxycedrus),
molla e egër (Malus communis),
murrizi njëbërthamësh (Crataegus monogina),
shtogu i zi (Sambucus nigra),
trëndafili i egër (Rosa canina),
drunakuqi (Arbutus andrachnea), mjedra (Rubus ideus),
qershigla (Vasinium myrtillus) etj.

Lloje barishtore me vlera të mëdha mjekësore mjaft të kërkuara nga tregu i jashtëm i industrisë farmaceutike si agulice (Primula officinalis), trumzë (Saturea Montana), shpendër (Helleborus odoratus), luleshtrydhe (Fragaria vesca), lulebasani (Hipericum perforatum), netull (Verbascum), lulëkuqe (Papaver rhoeas), hithra (Urtica dioica), qumështorja (Taraxum officinalis) etj. Përveç bimëve mjekësore në këtë territor gjendet një numër i madh bimësh barishtore me vlera të mëdha ushqyese për blegtorinë.

Mbulesa bimore e zonës minerare.

Mbulesa bimore e sipërfaqes ku do të hapet miniera karakterizohet nga bimesi mjaft të ulta kryesisht bar i cili shkon deri 20 cm gjatësi. Pemet e larta dhe shkurret pothuajse mungojnë fare.

Ajo është kryesisht zonë e çveshur, pa pyje të zhvilluara. Në sipërfaqe rriten pak drure të ulet në forme shkurresh, sic janë shkoza, dushku dhe pak dellinja, pak boshter dhe barishte.

Në zonen përreth sipërfaqes së minierës, vihet re dhe prania e drureve të lartë karakteristike për keto lartësi siç janë pisha dhe ahu.



Foto nga bimesia në sipërfaqe të minierës.

Bota shtazore.

Larmia dhe pasuria që ka kjo zonë si në aspektin klimatik, atë të tokave, të florës etj., ka krijuar kushte shumë të favorshme për zhvillimin e një bote shtazore shumë të larmishme. Këtë gjë e dëshmon ekzistenca e shumë llojeve të veçanta sipas karakterit të habitatit. Bota shtazore është shtrirë në gjithë teritorin si në atë të shkurreve, të pyjeve të pishës, të ahut, e në lartësinë e kullotave alpine dhe me pak habitateve ujore.

Në habitatet e ahut, habitat ky që në 20 vitet e fundit vërehet një rimëkëmbje dhe rigjenerim i plotë i tij, në të gjitha vlerat e biodiversitetit, ka gjetur kushte zhvillimi dhe jetese shumë lloje të kafshëve të egra si: lepuri, thëllënxa e malit, derri i egër, ujku, dhelpra, etj. Zona ku do të zhvillohet aktiviteti minierar është mbi zonën e dukshkut.

Në habitatet e pyjeve të ahut dhe të pishës, ku bën pjesë dhe zona minerare, që janë më të dëmtuara vitet e fundit dhe që vërehet një dëmtim i ekosistemeve dhe i faktorëve të biodiversitetit në tërësi, gjejmë një numër më të vogël të kafshëve të egra që jetojnë në këto zona si ariu, ujku, shqiponja, rrëqebulli, dhia e egër, kaprolli, etj.

Në habitatet e ujrave të kthjellta dhe të ftohta të përrrenjve që shtrihen poshte minieres rreth 600 ml takohet rallë trofta e egër dhe disa lloje të tjera peshqish autokton që e bën këtë zonë të dallueshme nga zonat e tjera të vendit. E gjithë kjo, pasuri e botës shtazore dhe me vlera të veçanta ofron kushte për zhvillimin e turizmit malor, familjar, sportiv, ekologjik, çlodhës, etj.

Fauna e zonës

Prania e larmishme e formacioneve pyjore është e lidhur edhe me egzistencën e llojeve të ndryshme të faunës së egër, gjitarëve si ariu i murrmë (*Ursus arctos*), derri i egër (*Sus scrofa*), ujku (*Canis lupus*), kaprolli (*Capreolus capreolus*), dhia e egër (*Rupicapra rupicapra*), shpendëve si shqiponja (*Aquila chrysaetos*), thëllënxa e malit (*Alectoris graeca*), gjeli i egër (*Tetrao urogallus*), skifteri (*Falco naumanni*), bufi (*Bubo bubo*), qukapiku (*Dryocopus martius*), mëllenja (*Turdus merula*) etj.

Zonat e mbrojtura dhe monumentet natyrore të mbrojtura me ligj, pranë vendit ku propozohet të zbatohet projekti.

Duke u konsultuar me kuadrin ligjor mbi zonat e mbrojtura dhe monumentet e natyres të mbrojtura me ligj, dhe nga rikonicioni në vend kemi konstatuar se sipërfaqja e vend burimit të kromit Theken (Gal.11-23) Martanesh, ku është hapur miniera nuk ben pjese ne zone te mbrojtur.

Gjithashtu është vërtetuar se në sipërfaqen e vend burimit dhe rreth saj nuk ka monumente natyre, listen e të cilit për rrethin e Bulqizes e paraqesim me poshte;

Monumentet e ntyres, Rrethi Bulqize

1. Druri i Male Zeqirit – Zerqan
2. Zabeli i Madh Zerqan
3. Shpella e ures se qytetit
4. D I A N I i Qytetit
5. Tre çesmat e Zerqanit
6. Bregu i Pepese (qarri i Pepese)
7. Qarri i Muharremit
8. Gurra dhe shpella e Zerqanit
9. Gurra e Vakefit te Zerqanit
10. Liqeni i Zi – Martanesh
11. Ujevara e Duriçit
12. Xixell Martanesh
13. Shpella e Xixëlles Valikardhe
14. Qarri i Allushit Valikardhe
15. Shpella e Ftohte Gjuras
16. Qarri i Kovashices
17. Vakufi Zerqan
18. Qarri Gjinovec
19. Pisha Zogje
20. Qarri Peladhi (Zerqan

b) Pershkrimi i cilesis se mjedisit, ujrart ajri etj.

Ujrat. Ujrat në zonën e studiuar për hartimin e raportit të VNM-së, janë të pastra. Kjo zonë karakterizohet nga 2 aktivitete kryesore, nga aktiviteti minerar i cili ze dhe vendin kryesor dhe nga aktiviteti pyjor, i cili për momentin është pothuajse i ndaluar.

Në këtë zonë ushtrohet dhe aktiviteti blektoral, më pak bujqësor,kohtë e fundit në disa fshatra kanë filluar që të meren dhe me kultivimin e peshkut.

Po ti analizojmë këto aktivitete konstatojmë se ato nuk ndotin ajrin duke mos ja ulur cilësinë mjaft të mirë që ka uji në këto anë. Ndonse aktiviteti minerar përshkon zonën dhe nga disa galeri (galeria nr.27dhe 28) dalin ujra, këto ujra janë të pastra kimikisht, kjo falë vetisë që ka minerali i kromit i cili nuk shpërbëhet në ujë dhe nuk e ndot atë.

Ajri. Ajri në këtë zonë është shumë i pastër, aktivitetet e zonës nuk e ndotin ajrin. Në rastet e transportit të mineralit apo të transportit të materialeve të tjera, kur është kohë e thatë dhe me erë, vende vende ngrihet re pluhutri e cila nuk zgjat shumë dhe nuk kalon përtej gjërësisë së rrugës.

Zhurmat. Përveçse punëve me lëndë plasëse të cilat emetojnë zhurma, në nëntokë dhe sipërfaqe, por nuk janë kronike dhe të vazhdueshme, ato zgjatin në kohë në fraksion seconte, si burim zhurme janë mejtet e punes, të transportit dhe ngarkimit. Mjetet e transportit janë i vetmi burim zhurme në këtë zonë. Por duke patur parasysh që zonat e banuara janë mjaft larg dhe mjetet e transportit kontrollohen periodikisht në kontrollin teknik, përfshi dhe nivelin e zhurmave, arrijmë në konkluzion që mjetet e transportit ndonse janë burim zhurmash, ato qarkullojnë rralle dhe niveli i zhurmave është brenda kufijve të lejuar.

Gazet dhe pluhuri.Procesi teknologjik i shfrytëzimit të minierës me galeri të thelluara kryhet nga mjetet e punes me shpim-plsje Mjetet e punes makinerite engarkimit dhe transportit janë objekt kontrolli periodike teknik të tyre ku ben pjese edhe emetimi i gazeve dhe nese ato nuk permbushin kushtet teknike nuk vihen ne pune.Ne miniere brenda ne frontin e punes perdoren maskat mbrojtese nga minaret dhe perdoret shpimi i lagur me uje. Gazet qe lindin nga perdorimi i L .plasese neutralizohen me ajer te paster konforme RST ne pune.

Mbetjet. Në zonën ku është hapur kariera dhe miniera nuk ka mbetje, ato mbetje urbane që do të përftoheshin nga aktiviteti njerzor do të jenë shumë të vogla në sasi dhe do të trajtohen njëjloj si mbetjet e tjera urbane që trajton qyteza Krastë.

Ndotje historike, erozion etj. Në këtë zonë nuk ka ndotje historike, për shkak të origjinës dhe përbërjes shkëmbore të terrenit, fenomeni i erozionit është shumë i vogël gati i pa vlerësueshëm, gjithashtu mungesa e pemëve të larta shmang rënijen e zjarreve.

Presionet kryesore të mjedisit në zonën e projektit. Në zonën ku është hapur kariera e miniera nuk janë konstatuar presione të tera mjedisore si prerje të pemëve apo ndotje të mjedisit. Aktiviteti minierar nuk shoqërohet me ndotje mjedis, ai gjithashtu nuk shoqërohet me prerje pemësh apo shpyllëzime. Ndërkohë që sipërfaqja ku është hapur miniera nuk është e veshur me pyje, ajo është e cveshur dhe vend vende ka shkurre të degraduara dushku dhe dëllinje.

b-1) Pershkrimi i kapaciteteve sociale të zones.

Përcaktimi administrativ.

Miniera për të cilën është hartuar raporti paraprak i VNM-se, bën pjesë në zonën që administrativisht përfshihet në territorin që mbulon Prefektura e Dibrës, bashkia e Bulqizës në krahinën e Martaneshit.

Popullsia dhe qendrat e banuara.

Zona, ku është hapur miniera, ndodhet në zonën e Martaneshit, ku qendrat e banuara më të afërta janë qyteza e Krastës dhe disa lagje fshatash Batra (Koxherra) dhe Batra (Lena) etj.

Dikur kjo zonë ka qenë mjaft e populluar, vetëm në qytezën e Krastës numuroheshin më shumë se 5 mijë banorë, fshatrat rreth saj ishin mjaft të populluar duke filluar nga fshati Peshk, i cili ndodhej në lindje të qytezës së Krastës, Gjoni (Melcu) Batra, Gjoni (Nderkrua) dhe Lena (Mullinjas) etj.

Mbas viteve 90 si në të gjithë zonat malore veri lindore e veriore, banorët për shkaqe që tashmë dihen, u shpërngulën dhe shkuan drejt qendrave të mëdha të banuara dhe afër bregdetit.

Për rrjedhojë numuri i banorëve këtu është zvogëluar në maksimum, sot në Krastë ka rreth 200-250 banorë, ndërsa fshatrat pothuajse janë braktisur totalisht, duke e çuar numurin e banorëve drejt zeros, vecanërisht në stinën e dimrit.

Përdorimi i tokës në zonën e projektit.

Zona e Martaneshit është ndër krahinë që renditet në krahinat e ndodhura në zonat malore kodrinore.

Kjo krahinë është e pasur me pyje dhe minerale kromi si dhe ujë sezonalë. Meqenëse pyjet janë shfrytëzuar pa kriter, sot atje nuk lejohet të shfrytëzohet për një kohë e cila do të bëjë të mundur rritjen e drurëve të gatshëm për shfrytëzim. Kullota malore janë një tjetër pasuri e zones, por që tashmë ka shumë pak mundësi shfrytëzimi për mungesë të banorëve dhe konkurrencë të fitimit më të madh nga minierat.

Minerali i kromit është pasuri mjaft e madhe dhe me vlera të mëdha ekonomike, shfrytëzimi i tij ka filluar rreth 50 vjet më parë dhe vazhdon me një ndryshim se tani aktiviteti është privat. Në rreth 90% të tij zhvillohet në nëntokë, ndërsa një pjesë mjaft e vogël zhvillohet në sipërfaqe të tokës me karrierë.

Përsa i takon sipërfaqes së tokës së bukës, kjo sipërfaqe është mjaft të reduktuar, ajo takohet në qendrat e banuara, lagje fshatrash dhe në formën e ngastrave të vogla për përdorim familjar, të cilët mundohen të mbjellin perime e zarzavate për përdorim vetiak.

Ekonomia e zonës dhe aktivitetet kryesore të saj

Zona e Martaneshit, ku ben pjese objekti dhe nga e cila do të sigurohet edhe fuqia punëtore për shfrytëzimin këtij objekti, është një zone me nivel të ulët ekonomik. Klima e ashpër, sipërfaqet e vogla të tokave bujqësore produktive, largësia e madhe nga qendrat e banuara, si Bulqiza e Burreli, si dhe infrastruktura në tërësi e dobët, rënia e aktivitetit minerar etj., kanë bere qe banoret e kësaj zone të lëvizin familjarisht drejt zonave të tjera të vendit.

Nder aktivitetet kryesore të popullsisë së kësaj zone, mund të përmendim:

Bujqësinë, blegtorinë, shfrytëzimin pyjor dhe përpunim druri, si dhe aktivitetin minerar i cili është aktiviteti që siguron të ardhurat kryesore për zonën dhe me gjere.

Kohet e fundit ka filluar që të ndërtohen dhe hidrocentrale me kapacitetet të reduktuar për sigurimin e energjisë elektrike për zonën.

Një pjesë e mirë e banorëve është aktivizuar si punëtore dhe specialiste në subjektet private, që aktualisht, janë të pajisur me leje minerare shfrytëzimi në ish sektorët e Batrës, si në minierat Thekën, Krastë, Batër, Lugu i Gjatë, Liqeni i Sopëve, Fushë-Lopë, etj.

Kjo zonë është e varfër me tokë buke, kjo për shkak të karakterit të saj kodrinor-malor dhe sipërfaqeve të çveshura.

Zona ku është hapur miniera është zonë mineral mbajtëse, për pasojë duke filluar nga viti 1983 e në vazhdim janë hapur punime minerare të cilat e kanë përshkruar të gjithë zonën, njëkohësisht kanë vërtetuar që në këtë zonë mungojnë objektet arkeologjike dhe monumentet e kulturës apo natyrës.

Vlerat dhe objektet monumentale dhe arkeologjike në afërsi të zonës së projektit.

Aktiviteti gjeologjiko-minerar ka rreth 60 vjet e më shumë që ka filluar dhe që nga data e fillimit e deri sot ai është intensifikuar në maksimum duke rritur sipërfaqen e kërkim zbulimit, sipërfaqen e minierave si dhe prodhimin.

Nga të gjitha punimet e kërkim zbulimit, punimet e hapjes dhe ndërtimit të minierave dhe karrierave nuk është takuar dhe konstatuar asnjë objekt monumental apo arkeologjik në këtë zonë të minierës.

Po kështu nga puna disa vjecare në minierën e Theknes (Obj. Gal.11-23), nuk është konstatuar dhe takuar asnjë objekt monumental apo arkeologjik.

Administrimi i mbetjeve dhe ujrave të ndotura urbane.

Qyteza e Krastës filloi të ndërtohej në vitet 1970 e në vazhdim deri në vitin 1990. Kjo qytezë u ndërtua për të strehuar me banim minatorët që punonin në minierë e kromit 11 Heronjt Batër, numuri i të cilëve shkante deri 4000 punëtorë. Gjatë ndërtimit të kësaj qyteze u ndërtua dhe infrastruktura e nevojshme duke filluar nga banesat në formë pallatesh deri 4 kate me të infrastrukturën e nevojshme, rrugët, rrjeti i kanalizimeve të ujrave të zeza, ujësjellësi me rrjetin e shpërndarjes së ujit të pishëm, linja elektrike për furnizim, linja telefonike për komunikim e ndërlidhje.

Kjo infrastrukturë u ndërtua për të siguruar jetesë për një popullsi mbi 5000 banorë. Sot atje jetojnë rreth 200-300 banorë, të cilët kanë në dispozicion të gjithë infrastrukturën. Megjithatë duhet theksuar se në këtë qytezë tashmë të boshatisur kërkohet që mbetjet urbane të trajtohen konform ligjit për administrimin e integruar të mbetjeve urbane. Ujrat e ndotura urbane, në qendrën e banuar të Krastës, trajtohen njësoj sikur janë trajtuar para viteve 90

Ndërsa aktiviteti minerar në minierën Theken (Gal.11-22) nuk gejnëron mbetje urbane dhe ujra të ndotura.

c) - Informacion lidhur me identifikimin e ndikimeve.

Ndikimet negative në mjedis.

Cdo aktivitet i cfarido natyre qofte karakterizohet nga disa efekte mjedisore negative apo pozitive te cilat sipas natyres mund te jene afatshkurtra ose/dhe afatgjata, te minimizueshme ose te eliminueshme. *Evidentimi i tyre dhe marrja ne konsiderate gjate aktivitetit te ndikimit ne mjedis eshte parakusht per nje partneritet ne mbrojtjen emjedisit.*

Duhet te theksojme se shumica dermuese e punimeve pergatitore qe perfshin ky projekt jane kryer shume vite me pare e per pasoje ndryshimet nga kjo faze tashme jane pershtatur me mjedisin dhe jane bere pjese e tij.

Identifikimi i ndikimeve të mundshme negative në tokë

Ndikimi i mundshëm	Pasoja në mjedis
Shqetësim i shtresës së tokës për shkak të hapjes së karrieres,punimittë hapjes dhe gjysmë transheve	Krijim i hinkave ne sipërfaqe dhe ulje e sipërfaqes se tokes.Kjo sasi dheu mund të sistemohet përgjatë hapjes minieres dhe të përdorët në fazën e fundit për qëllime rehabilitimi
Shqetësim i nentokes per shkak te terheqjes se mineralit te kromit gjate shfrytezimit.	Krijim te hapsirave nentoksore. Ne sistemin e shfrytezimit parashikohet qe nje pjese e tyre dhe te rimbushet me sterile.
Lëvizje e mjeteve të punës dhe automjeteve të transportit si kamione fadroma etj, mbi sipërfaqen e tokës krijojnë ngjeshje te saje.	Ngjeshja e tokës nga lëvizja e automjeteve dhe mjeteve gjatë punimeve të rikonstruksionit dhe atyre të reja do të limitohet brenda sipërfaqes së kërkuar
Erozion minimal ne kohe me rreshje ne sipërfaqen ku do të hapet kariera	Largim i grimcave të tokës që ekspozohen ndaj agjenteve atmosferike duke u shkeputur dhe levizur kryesisht drejt trupave ujore si perrenjte dhe prroskat ne afersi te objektit
Avari teknike, derdhje e karburanteve dhe lubrifikantëve.	Ndotje e tokës si pasoje e rrjedhjes se lubrifikanteve dhe karburanteve po per shkak te vellimit jo te madh te punimeve dhe numrit te reduktuar te makinerive, ndotja do te jete ne sasi te vogla
Gërmime për shkak të hapjes së gjysmë transheve nga makinerite	Vibrim i tokës, por gjykuar nga volumi i punimeve do te jete nje vibracion normal teknologjik vetem ne nje zone te ngushte te objektit
Nga punët me lëndë plasëse në sipërfaqe dhe nëntokë	Shkriftim i shkëmbit mëmë dhe mineralit si dhe vibrim i zonës rreth ku bëhen punët e shpim plasjes.

Identifikimi i ndikimeve të mundshme negative në ajër

Ndikimi i mundshëm	Pasoja në mjedis
Shkarkim i sasise minimale te gazeve nga automjetet	Ndotje e ajrit. Sasia e gazeve NO ₂ dhe SO ₂ qe do te shkarkohet eshte standard i teknologjise se automjeteve qe do te perdoren gjate punimeve te parashikuara
Emetim zhurmash nga automjetet e transportit dhe mjetet e punes	Ndotje akustike nga mjetet e punës për bërjen e birave dhe për ngarkim transport të mineralit. Objekti është i distancuar nga qendrat e banuara, kështu qe rritja e nivelit te zhurmave nuk do te krijoje probleme per banoret, vetem per faunen. Gjithsesi operacionet e punes do te jene te limituara ne kohe dhe nje pjese e tyre do te kryhen nentoke
Krijimin e sasive të pluhurit si pasoje e qarkullimit të kamioneve jashte objektit dhe transportit të mineralit	Ndotje ajri. Ky fenomen do te jete me I dukshem gjate stines se thate, ne sasi te limituara per shkak te volumit te punimeve dhe do te shqetesoje kryesisht faunen ne zone, pasi qendrat e banuara jane larg dhe bimesia e rralle
Sasira minimale pluhuri nga cekicet	Lagje e vazhdushme e frontit te punes dhe vendosja e shpimit te lagur.

pneumatike per birat e shpim –plasjes.	
--	--

Identifikimi i ndikimeve të mundshme negative në biodiversitet

Ndikimi i mundshëm	Pasojat në mjedis
Ndërhyrje në habitatet ne zone , shqetesim i faunes.	Dëmtim i habitateteve. Siperfaqja ku janë kryher punimet eshte e varfer ne bimesi dhe rrjedhimisht,proceset ekologjike jane minimale dhe te kufizuara. Disa procese qe lidhen me shume me shqetesimet dhe cilesine e mjedisit, do te ushtrojne ndikimet e tyre ne boten e gjalle sidomos do te mbajne larg zones disa lloje shtazore

Identifikimi i ndikimeve të mundshme negative në peisazh dhe relief.

Ndikimi i mundshëm	Pasojat në mjedis
Ndikime ne pejsazh dhe topografine e terrenit ku ndodhet objekti si rezultat i karierës dhe depozitimit të sterilit të punime minerare	Nder ndikimet me evidente do te jene ndryshime i relievit dhe peisazhit, nga pjerrësia natyrale qe do te kene shkallët e karierës me lartësi 10 ml.. Stoqet e depozitimit të sterilit të punimeve minerare jane ekzistuese ato do të ndryshojnë gjithashtu relievin dhe peisazhin e vendik ku jan depozituar

Mbetjet e ngurta

Ndikimi i mundshëm	Pasojat në mjedis
Gjenerim i mbetjeve nga aktiviteti njerezor	Ndotje urbane. Kartona, bidona vaji, ambalazhe dhe qese plastike nga ambalazhet dhe aktiviteti i punonjesve
Minerali dhe sterili ne sasira te konsiderushme	Zenie e siperfaqes se tokes per stoqet e depozitimit te sterileve qe dalin nga kryerja e punimeve dhe sheshet e depozitimit te mineralit te prodhuar.

Ndikimet negative shtesë.

Veprimtaria minerare nxjerrës e mineralit të kromit, është veprimtari e cila nuk shoqërohet me ndikime negative shtesë, në cilësinë e mjedisit rrethues të minierës e më gjërë. Ky aktivitet nuk ndikon negativisht gjere në sipërfaqenapo bimësinë e ulët deri në pemët e larta, pyjet.

Ky aktivitet nuk ka shkarkime të ujrave të ndotur, gjithashtu nuk ka shkarkime në trupat ujqorë rreth minierës, lumenj, përrenj, rezervuarë, ujë mbledhës përfshi dhe burimet ujore.

Ndikimet sociale të projektit, të tilla si ndryshimi i përdorimit të tokës dhe shqetësimet që mund të lindin nga ndikimet në mjedis të projektit (si zhurma, pluhuri, përdorimi i burimeve natyrore etj).

Ky projekt, nxjerrja e mineralit të kromit në minieren Theken Gal.11-23, shoqërohet me ndryshime të përdorimit të tokës aty ku është ndërtuar zona e miniera. Këto ndryshime nuk shoqërohen me ndikime negative të cilat të kenë ndikim negativ në jetën sociale. Ndikimet negative janë vetëm në relief dhe në peisazh.

Po ti analizojmë këto ndikime, ato nuk rezultojnë negative sepse janë ndryshime të pa shoqëruara me ndryshime të strukturës kryesore të tokës si dhe nukshoqërohen me ndotje mjedisi apo me shkarkime të elementëve të dëmshëm për mjedisin. Sterilet janë pjesë përbërëse e shkëmbinjve që formojnë zonën dhe relievin.

Ndërkohë po të rendisim ndikimet pozitive të këtij aktiviteti (shfrytëzim të burimeve minerare për interes të njerëzimit, rritje e mrëqënijes së punonjësve, reduktim i papunësisë në zonë, kualifikim i mëtejshëm i puntorve, si dhe vend ndodhjen e minierës në një zonë shumë larg qendrave të banuara, sipërfaqen e vogël të shesheve, etj) dhe ti balafaqojmë me ndikimet negative vërejmë se ndikimet negative nuk përbëjnë problem

Metoda e zbatuara për parashikimin e ndikimeve negative

Për parashikimin e ndikimeve negative të projektit në mjedis (aktiviteti i nxjerrjes së mineralit të kromit me galeri te thelluara) u ndoqën hapat e mëposhtme:

- ✧ Konsultimi me kuadrin ligjor mjedisor.

- ✧ Njohja dhe studimi i projektit, teknologjia e tij, mënyra e propozuar për shfrytëzim, sasitë nxjerrëse, makineritë etj
- ✧ Njohja me infrastrukturën ekzistuese të trashëguar të objektit (galeria, kanalet, shpimet, stoku i vjetër i sterilit, sheshet e trashëguara etj) dhe nevojën për infrastrukturë të re për projektin,
- ✧ Njohja me natyrën e operacioneve të nevojshme në mjedis, (gërmime, stokime të mineralit e sterili, ndërtime etj)
- ✧ Njohja me vlerat natyrore dhe mjedisore të zonës dhe sipërfaqes,
- ✧ Historiku i ndërveprimit mjedisortë të minierave dhe karrierave në aktivitet dhe të mbyllura me zonën,
- ✧ Konsultimi me shumë dokumenta e raporte të VNM përveprimtari të njëjta.
- ✧ Mrje e kampioneve të shkëbinjve dhe të mineralit dhe interpretimi i rezultateve të analizave të tyre.
- ✧ Marja e kampioneve dhe analiza e tyre në ujrë të cilat dalin nga galeri minerare të minierave të kromit pranë minierës së Theknes Galerite Nr.1 dhe 23 e përroit të Theknes.
- ✧ Konsultimi me banorët e zonës.

Shtirja fizike dhe kohezgjatja e mundshme e ndikimeve negative të identifikuar.

Aktiviteti minerar i shfrytëzimit në këto miniera ka filluar rreth viteve 1963 dhe ka vazhduar deri në vitin 1996. Subjekti aktivitetin minerar ka filluar nga viti 2000, kur subjekti “D I A N I” shpik u pais me leje për shfrytëzimin e kësaj miniere, arrijmë në konkluzionin se efektet negative të identifikuar nuk kalojnë me teper se kohezgjatja e lejes minerare përtej kufinjve të saj në hartën topografike.

Efektet negative të identifikuar në këtë projekt nuk i kalojnë kufijtë e sipërfaqes kufizuar me koordinatë sipas tabelës së koordinatave, bile mund të themi që *ato nuk identifikohen në të gjithë sipërfaqen, por vetëm në disa pjesë të saj. Konkretisht këto ndikime identifikohen në sipërfaqen e minierës, në vend hyrjet e galerive dhe në vend depozitimet e sterileve.*

Ndikime negative të identifikuar në sipërfaqen e kufizuar nga tabela e koordinatave sipas lejes minerare, janë:

- ✧ Nga mjetet e punës gjatë hapjes dhe shfrytëzimit
- ✧ Nga zbulimi i mineralit
- ✧ Nga hapja e galerive
- ✧ Nga depozitimi i sterilit
- ✧ Nga transporti i mineralit dhe sterilit.

Duke i analizuar një e nga një vërejtje se këto ndikime negative nuk janë të përhershme. Kohëzgjatja e këtyre ndikimeve varet nga jeta e minierës. Në projekt është parashikuar që jeta e minierës do të jetë 20-25 vjet, pastaj do të mbyllet miniera dhe sheshet e depozitimit. Duke shtuar që në vitin pasardhës do të bëhet rehabilitimi i minierës dhe stokeve, konkludojmë që kohëzgjatja e ndikimeve është 20-25 vjet.

Pra të gjitha ndikimet negative do të zgjaten sa jeta e minierës, ndërsa ndikimet në reliev dhe peisazh nga hapja e minierës do të vazhdojnë deri sa të zbatohet projekti i rehabilitimit për minieren, zakonisht dhe 3 vjet mbas mbylljes së minierës.

Lloji i ndikimeve të identifikuar.

Ndikimet e identifikuar janë të gjitha direkte, këtu mund të përmendim ndikimet në peisazh dhe ndikimet në reliev, ndërsa ndikime indirekte nuk ka.

Është rëndësishme të theksohet se nga ky aktivitet nuk ka shkarkime në ujë, në ajër dhe në tokë, të vetmet shkarkime janë mbetjet minerare të cilat nuk janë të dëmshme sepse ato janë pjesë e shkëmbinjve të zonës

e) Mundësia e zbutjes së ndikimeve.

Vepriktaria e nxjerrjes së mineralit të kromit, shoqërohet me ndryshim të relievit dhe peisazhit në sipërfaqen e karrierës, sipërfaqen ku depozitohet sterili dhe në hyrje të galerive.

Pavarsisht se këto ndryshime nuk ndikojnë negativisht në mjedis dhe ementët e saj, ujë, ajër dhe tokë, por kanë ndikim relativ të peisazh, subjekti " D I A N I " ka marrë dhe do të marrë masa për ti minimizuar dhe zbutur ato.

Ndër masat paraprake që meren deri sa të përfundojë shfrytëzimi janë:

Sistemimi i sterileve të depozituara

Hapja e kanaleve për disiplinimin e ujrave të rreshjeve atmosferike, anash karrierës, anash vend grumbullimit të sterileve, anash hyrjeve të galerive dhe shesheve të punës.

Këto masa do të finalizohen me zbatimin e planit të rehabilitimit të mjedisit i cili do të filljë të zbatohet 3 vitet e fundit të jetës së minierës.

Zonat e ndjeshme ndaj ndikimeve të projektit. (zona të mbrojtura dhe habitate, qendra të banuara, burime ujore, zona arkeologjike etj)

Ky aktivitet po mbush 17 vjet që nga data e fillimit nga subjekti D I A N I shpk. Gjatë kësaj periudhe aktiviteti është ushtruar dhe do të vazhdojë të ushtrohet jashtë zonave të mbrojtura, larg qendrave të banuara, burime ujore, dhe zonave arkeologjike etj

f) . Nikimi nderkufitare.

Vend burimi ndodhet në krahinen e Martaneshit, bashkia Bulqizës, Qarku i Dibrës, rreth 35 km larg në vijë ajrore nga pika më e afërt me kufirin me Maqedoninë. Jo vetëm distanca e largët por dhe lloji i vepriktarisë, minerare me nëntokë, përjashton mundësinë e ndikimeve nderkufitare të këtij objekti.

Ndikimet pozitive ne mjedis ne zonen e projektit

Shfrytëzimi i burimeve natyrore dhe veçanërisht minerare është domosdoshmëri për të vazhduar aktivitetin njerëzor. Aktiviteti i nxjerrjes së mineralit të kromit në objektin Theken .Gal.Nr,11dhe 23 ,Martanesh ka ndikime pozitive në mjedisin e zonës si më poshtë:

- ✧ Vënie në efikasitet të burimeve minerare të zonës.
- ✧ Nxjerrjen e mineralit të kromit shumë të kërkuar në tregun e brendshëm dhe të jashtëm.
- ✧ Ulje e numurit të papunësisë në zonë.
- ✧ Rritjen e mirqënijes së banorëve.
- ✧ Përhapjen e eksperiencës minerare dhe trashëgimin e profesioneve në minierë
- ✧ Zhvillimin urban të zonës dhe përmirsimin e infrastrukturës.
- ✧ Sigurimin e lëndës së parë për metalurgjinë e kromit
- ✧ Përfitim të metalit të kromit aq të kërkuar në industri.

- Masat zbutese te propozuara gjete fazes pergatitore.

Masat e mundëshme për shmangien dhe zbutjen e ndikimeve në mjedis.

Në hapjen dhe shfrytëzimin e karrierës dhe minierës, është marrë në konsideratë mbrojtja e mjedisit dhe standartet mjedisore si dhe të aplikohen masa konkrete.

Identifikimi i masave zbutese te propozuara ne toke.

Lloji i ndikimit	Masat e propozuara
Shqetesim i shtreses se tokes per shkak te hapjes se minieres dhe hapjes së shesheve.	Sasia e dheut sistemohet pergjate shpatit dhe do te perdoret per qellime rehabilitimi ne faza te ndryshme te shfrytezimit ose per rehabilitimin e rrugeve dhe siperfaqeve te demtuara ne perfundim te shfrytezimit te minieres

Ngjeshje e pjesshme e tokes nga levizja e automjeteve te transportit si kamione etj.	Per parkimin e makinerive dhe automjeteve dhe dhe kryerjen e sherbimeve te mirembajtjes do te shfrytezohen vendet e caktuara
Erozion siperfaqesor ne mot me rreshje	Janë hapur kanalet e drenazhimit ne sipërfaqe, qe do te ndalim forcen gerryese te ujrave te reshjeve, ndersa pergjate perimetrit te sheshit te depozitimit te mineralit dhe hyrjes ne nentoke, janë hapur kanale perimetrike kufizuese qe frenojne gerryerjen dhe transportin e tokes sipas gradientit te pjerresise nga ujrat siperfaqesore. Ne pjese te vecanta do te shihet mundesia e mbjelljeve te fidaneve pyjore te pershtatshem per zonen.
Ndotje e tokes si pasoje e avarive te mekanikes	Makinerite e shfrytezimit dhe transportit kontrollohen per gjendjen e tyre teknike dhe nese konstatohen pjese te amortizuara qe mund te rrjedhin lubrifikante zevendesohen me te reja. Ne rast te ndonje aksidenti dhe rrjedhjeve aksidentale te lendeve ndotese ne mjedis merren masa per pastrimin e menjehershem te tokes se ndotur e cila do te depozitohet ne nje kazan te posatshem metalik ose prej betoni per t'u trajtur me pas

Identifikimi i masave zbutese te propozuara ne ajer

Lloji i ndikimit	Masat e propozuara
Emetime te pluhurit, zhurmes, gazeve, aromave dhe vibracione	Manikerite mirembahen teknikisht qe zhurma e tyre te jete vetem ajo teknologjike dhe jo e avarive. Ato perdoren me eficence dhe te minimizohet koha gjate se ciles mbahen ndezur motoret. Skapamentot janë të kompletuara me filtrat e tyre teknologjike te kapjes se grimcave (skapamentot e makinerive kane nje jastek te posatshem per kete gje). Perdoret naftë me permbajtje te ulet squfuri. Menjanohet renia e borive te automjeteve nga shoferet per te mos krijuar zhurme dhe stres të panevojshëm. Qarkullimi i kamioneve ne qendrat e banuara behet me shpejtesi te ulet gje qe shmang jo vetem aksidentet por edhe krijimin e pluhurave.
Ndotja e ajrit si pasoje e qarkullimit te automjeteve brenda teritorit te minieres	Mjetet e trasportit jane objekt i kolaudimeve periodike, gjithashtu ato jane objekt i kontrollit nga vete subjekti. Ne rastet kur ato emetojne gazra mbi normat e lejuara si rezultat i defekteve hiqen nga qarkullimi dhe riparohen.
Ndotja e ajrit si pasoje e punes me shpim -plasje	Ne keto raste behet lagia me uje perpara shpimit ne menyre qe te minimizohet sasia e pluhurit te gjeneruar. Perdoret kur eshte e mundur shpimi i lagur dhe punonjesit jane te paisur me maska. Ndersa ne zonat e banuara nuk do te kemi ndikime pasi miniera eshte larg tyre dhe shpimet behen ne miniere.

Identifikimi i masave zbutese te propozuara ne biodiversitet

Lloji i ndikimit	Masat e propozuara
Shqetesim i faunes se zone	Shfrytezimi i mineralit eshte domosdoshmeri por respektohet rigorozisht siperfaqja e lejes per nderhyrje .Punimet zhvillohen ne siperfaqe me karriere dhe nentoke me galeri te thelluara. Depozitimi i sterilit dhe mineralit te nxjerre depozitohen jashte ne siperfaqe. Prandaj behet shume kujdes dhe respektohen stoqet dhe sheshet e sterileve dhe te mineralit te trasheguara, ndersa mjetet dhe makinerite kontrollohen periodikisht.

Identifikimi i masave zbutese ne peisazh.

Lloji i ndikimit	Masat e propozuara
Ndikime ne pejsazh dhe topografine e relievit, në karriere dhe hyrje të galerive	Depozitimi i sterileve dhe mineralit ne siperfaqe demtojne siperfaqen e relievit. Këto sipërfaqe do të rehabilitohen menjëherë sapo të mbarojë shfrytëzimi i karrierës.

Identifikimi i masave zbutese mbetjet e ngurta

Lloi i ndikimit	Masat e propozuara
Depozitim i sasirave te konsiderushme te sterileve	Keto depozitime demtojne siperfaqen dhe relievin. Subjekti do te minimizoje sa me teper nxjerrjen jashte ne siperfaqe te sterileve pasi nje pjese te tyre(40%) do ti depozitoje ne hapsirat e nentokes te krijuar nga terheqja e mineralit.Keto siperfaqe jane objekt i rehabilitimit sapo te mbaroje shfrytezimi.
Gjenerim i mbetjeve nga aktiviteti njerzor	Mbetjet e gjeneruara nga aktiviteti jetesor i punetoreve apo ambalazhet grumbullohen në vende të posaçme. Ato transportohen drejt drejt qendrave me te aferta te banuara per menaxhim nga sektoret perkates te pushtetit lokal.

Mbetjet qe dalin nga shfrytezimi i minieres.

Lloji i Mbetjeve	Kodi
Mbetje qe dalin nga nxjerrja e mineraleve metalore.	01 01 01
Sasi te tjera nga ato te permendura ne 01 03 04 dhe 01 03 05	01 03 06
Mbetje pluhurash,te tjera nga ato te permendura ne 01 04 07	01 04 10

Mbetje qe gjenerohen nga aktiviteti njerzor

Lloji i Mbetjeve	Kodi
Leter dhe kartona	20 01 01
Qelq	20 01 02
Plastikat	20 01 39
Mbetje te tjera	20 03

- Masat per zbutjen e ndikimeve gjate fazes se shfrytezimit

Identifikimi i masave zbutese ne toke

Lloi i ndikimit	Masat e propozuara
Shqetesim i siperfaqes se tokes per shkak te shfrytezimit te mineralit te kromi	Sterilet e nxjerra nga krijimi i hapsirave nentoksore dhe shesheve te shfrytezimit sistemohen ne ane te shpatit per tu rikthyer me vone pas shfrytezimit per rehabiulitim te tyre.
Shqetesim i siperfaqes se tokes per shkak te shfrytezimit te mineralit te kromit afer siperfaqes	Lenie te koollonave dhe tanikeve mbrojtjes per temos u u shembur hapsirat e shfrytezimit dhe gropat e krijuara ne siperfaqe
Shqetesim i nentokes per shkak te shfrytezimit te mineralit te kromit	Punimet e shfrytezimit behen shume thelle, lihen disa kollona mbajtese ne netoke,nuk kemi ndikim prane siperfaqes dhe hyrjes se galerive
Dentimi i tokes nga levizja e mjeteve te punes dhe automjeteve te transportit(kamione etj)	Trasporti dhe levizje e mjeteve te punes behet vetem ne rruget e percaktuara me pare. Rruget tashme jane te konsoliduara dhe nje pjese e tyre te shtruara me cakell.
Erozioni ne kohe me reshje ne pjeset anesore te rrugeve.	Jane hapur kanale anesore per te parandaluar kalimin e ujrave me rrembim dhe per te disiplinuar keto ujra drejt trupave ujore si prroska ,perrej etj
Shqetesim i tokes si pasoje e avarive te mekanikes.	Mjetet e transportit mirembahen rregullisht dhe jane objekt i kontrollit periodik. Ne raste difektsh ato riparohen dhe futen ne transport.
Lekundjet e tokes si pasoje e punimeve te shpim plasjes per shfrytezim te kromit	Punimet e shpim –plasjes kryhen ne thellesi te medha. Keto punime kryhen ne zbatim te pasaportave teknike te hapjes dhe sjfrytezimit ne te cilkat jane parashikuar dhe sasite e L.Plasese qeduhet te perdoret per nje shperthim.

Identifikimi i masave zbutese ne ajer.

Lloi i ndikimit	Masat e propozuara
Ndotja e ajrit si pasoje e shkarkimit te sasise minimale te gazeve nga automjetet e ngarkim-trasportit	Kontrol periodik i automjeteve te transportit dhe rpiarim i shpejte i defekteve. Kolaudim te rregullt cdo vit.
Krijohen zhurma nga automjetet e transportit djem mjetet e punes.	Mjetet kolaudohen cdo vit ne menyre periodike dhe ne cdo rast defekti riparohet menjehere.
Ndotje e ajrit nga pulhuri si pasoje e punimit me shpim-plasje	Ne kete rast behet lagia mem uje e frontit perpare shpimit ne menyre qe te minimizohet sasia e pluhurit. Punonjesit do te jene te paisur me maskat mbrojtese.Perdoret kur eshte e mundur shpimi i lagur Ndersa ne zonat e banuara nuk do te kemi ndikime pasi miniera eshte larg tyre dhe shpimet behen ne miniere.

Identifikimi i masave zbutese ne biodiversitet

Lloi i ndikimit	Masat e propozuara
Krijimi i zhurmave,pluhurit, vibrimet ne nentoke dhe siperfaqe nga shfrytezimi i kromit	Punimet zhvillohen ne siperfaqe me karriere dhe nentoke me galeri te thelluara. Depozitimi i sterilite dhe mineralit te nxjerre depozitohen jashte ne siperfaqe. Prandaj behet shume kujdes dhe respektohen stoqet e sterileve dhe sheshet e mineralit te trasheguara, ndersa mjetet dhe makinerite kontrollohen periodikisht

Identifikimi i masave zbutese ne peisazh

Lloi i ndikimit	Masat e propozuara
Ndryshim i peisazhit dhe relievit ne permasa mjaft te vogla	Depozitimi i sterileve ne stogjet e trasheguara, sasite qe do te depozitohen do te jene mjaft te kufizuara pasi nje pjese e tyre depozitohetn/toke.Depozitimi i tyre ne stoqet ekzistuese.

Mbetjet e ngurta

Lloi i ndikimit	Masat e propozuara
Rritje te sasis se seterileve ne siperfaqe	Depozitimi i tyre ne stogjet ekzistuese sasite jane te vogla
Ndotjet nga mbetjet urbane	Trajtimi i tyre njesoj si mbetjet urbane te qytezes se Krastes.

Programi i monitorimit te ndikimit ne mjedis

Subjekti ‘D I A N I ‘ shpk ka planifikuar qe te monitorojë ndikimin e mjedis për veprimtarinë minerare. Për këtë qëllim do bashkëpunojë me Agejncinë Rajonale të Mejdisit Dibër për të miratuar programin e monitorimit në të cilin çështjet kryesore jane si me poshtë:

Program i monitorimit

- ✧ Monitorim i sipërfaqeve të zbuluara të karrierës
- ✧ Monitorimi faktoreve qe shkaktojne fatkeqesi natyrore dhe humane
- ✧ Monitorim i gjendjes teknike te punimeve minerare(galerrive)per shmangjen e aksidenteve
- ✧ Monitorim i gjendjes se mekanikes dhe mundesis per rrjedhje dhe ndotje.
- ✧ Monitorim i zhurmave te mjeteve te ngarkim-shkarkimit
- ✧ Monitorim i ajrit ne miniere dhe pluhurit nga shpim-plasja
- ✧ Monitorim te zonave te rezikshme te trasheguara nga miniera
- ✧ Monitorim i sterileve qe do te dpozitohen nga zbulimi dhe hapja e punimeve minerare
- ✧ Monitorim i ujrave qe dalin nga miniera (nese do te ketë në të ardhmen ujra qe dalin nga miniera)
- ✧ Monitorim i sjelljes se bimesis rreth minieres
- ✧ Monitorim i ajrit rreth karrierës, ndonse eshte aktivitet pa shkarkime ne ajer.
- ✧ Moniitorim i zhurmave te mjeteve te punes.

Plani i menaxhimit dhe monitorimit te mjedist

Rolet dhe përgjegjësitë për zbatimin e masave të propozuara për mbrojtjen e mjedisit.

Subjekti " D I A N I " shpk, është subjekt i cili në përputhje me veprimtarinë minerare të nxjerrjes së mineralit të kromit në minierën Theken ,Gal.11 dhe 23, ka rekrutuar dhe puntorë dhe specialistë. Për të realizuar prodhimi vjetor prej 1200 ton mineral kromi dhe 120 ml ne vit punime minerare, subjekti ka rekrutuar 7 punonjës.

Kjo fuqi puntore është e angazhuar për të realizuar detyrat e prodhimit dhe punimet minerare. Gjithashtu specialitetet e profesioneve minator, armator dhe mekanik kryejnë dhe detyrat për realizimin e masave për mbrojtjen e mjedisit.

Në masat e propozuara për mbrojtjen e mjedisit ndikojnë faktorët e mëposhtëm:

- ✧ Zbatimi i projektit dhe pasaportave teknike për hapjen e punimeve minerare.
- ✧ Zbatimi i projektit për vend depozitimet e sterilit të punimeve minerare.
- ✧ Zbatimi i pasaportave teknike për depozitim dhe ruajtjen e qëndrueshmërisë së stokeve të depozitimit tësterileve.
- ✧ Zbatimi i projektit të hapjes dhe shfrytëzimit të karrierës.
- ✧ Mirmbajtjen e mjeteve të ngarkim transportit etj.

Për realizimin e këtyre detyrave do të angazhohet i gjithë personeli i subjektit D I A N I shpk, në drejtimin e drejtuesit teknik dhe punonjësve të specializuar.

Mundësia e rehabilitimit të mjedisit të ndikuar dhe kthimi i tij në gjendjen e mëparshme dhe kostoja përkatëse të zbatimit të masave të propozuara për mbrojtjen e mjedisit

Subjekti ka planifikuar që pasi të ketë mbaruar aktiviteti i shfrytëzimit të minierës do të marrë keto masa për rehabilitimin e zonës të cilat do të jenë:

Punimet inxhinierike

- Mirembajtja e hyrjeve të galerive (traverbangjeve) dhe punimeve vertikale dhe të pjerrta me dalje në sipërfaqe
- Mirembajtje të rrjetit rrugor në minierë
- Hapje të kanaleve për drenazhimin dhe disiplinimin e ujrave
- Mbylljen pas perfundimit të aktivitetit të hyrjeve të punimeve minerare horizontale dhe vertikale e të pjerrta me dalje në sipërfaqe.
- Punimet biologjike
- Mbjellje të drurëve autoktone të zonës pasi zona ka të tillë.
- Mbjellje të bimesis
- Sherbimet profilaktike në sipërfaqen e rehabilituar.

Gjatë rehabilitimit të mjedisëve në minierën Theken Gal.11dhe23' duhet të kihet parasyhse faktorët e mëposhtëm:

- ✓ Rezervat e mineralit të kromit në objektin minierar dhe jetegjatesia e minierës
- ✓ Trashgimia,ndertimet sipërfaqësore,stoqet e depozitimit të sterileve,sheshet e mineralit dhe materialeve.
- ✓ Perjashtimi nga projekti i rehabilitimit i ndertimeve sipërfaqësore.
- ✓ Ushtrimi i aktivitetit të nxjerrjes së mineralit nga karriera dhe nentoka me galeri brenda sipërfaqes së licensuar.
- ✓ Vazhdimi i depozitimit të sterileve
- ✓ Vazhdimi i nxjerrjes së mineralit të kromit e aktivitete të tjera ndihmese nga subjekti jone dhe jo të tjere.

Pavarsisht nga sa më sipër subjekti paguan çdo vit garancinë e rehabilitimit. Kjo garanci paguhet në zbatim të kuadrit ligjor(Vendimit 714) , dhe në zbatim të Ligjit Nr 10304, datë 15.7 2010, "Për sektorin

minerar në Republikën e Shqipërisë” dhe akteve nën ligjore në zbatim të tij. Për periudhën 2011-2017 subjekti D I A N I ka paguar për garancinë e rehabilitimit shumë sipas tabelës së mëposhtme:

Tabela e garancisë e rehabilitimit të mjedisit.

Nr	Viti	Vlera e paguar në lekë
1	2011	77 439
2	2012	77 439
3	2013	77 439
4	2014	77 439
5	2015	77 439
6	2016	77 439
7	2017	77 439
5	Shuma	542 073

Plani i menaxhimit te mjedisit mbështetet në:

- ✧ Zbatim të projektit teknik të hapjes dhe shfrytëzimit të karrierës dhe minierës
- ✧ Hapje e gjysëm transheve dhe galerive e shkallëve të karrierës në vendet e projektuara
- ✧ Sistemimi i sterileve ne vend depozitimine sterileve dhe pergatitja e stoqeve të sterileve për tu rehabilituar, përsfhi dhe mbjelljen e fidaneve të bimve të zonës
- ✧ Respektimin e të gjitha standarteve mjedisore në hapjen e karrierës dhe minierës dhe në shfrytëzimin e tyre për nxjerrjen e mineralit të kromit në objekt.
- ✧ Rehabilitimin progresiv dhe total të sipërfaqes ku ushtrohet aktiviteti minerar, në përfundim të këtij aktiviteti

Më poshtë jepen disa indikatorë të cilët duhen monitoruar për të vlerësuar suksesin dhe matur realizimin e objektivave mjedisore të projektit.

Nr	Elementi i monitorimit	Frekuenca
1	Monitorim i zhurmave dhe pasojave të plasjes në karrierë e minierë	Vazhdimisht
2	Monitorimi i biodiversitetit ne zonen rreth objektit te shfrytezimit	Vazhdimisht
3	Monitorim i pluhurave në objekt dhe gjatë transportit	Në stinën e thatë
4	Monitorimi i gjendjes se mekanikes dhe mundesise per rrjedhje dhe ndotje	Vazhdimisht
5	Monitorim i faktorëve që shkatojnë fatkeqësi natyrore dhe humane	Vashdimisht
6	Monitorimi i elementeve minerar	Vazhdimisht
7	Monitorimi i qendrueshmerise se shkalleve te karrieres	Vazhdimisht
8	Menaxhimi dhe monitorimi i stoqeve te sterileve	Vazhdimisht

Subjekti “D I A N I”sh.p.k, të dhënat që do të përftohen nga monitorimi i parametrave të mësipërm do të shërbejnë për të:

- ✧ Përmirësuar dhe rikorigjuar masat e marra përmbrojtjen e mjedisit;

◇ Vlerësuar efektivitetin e masave të marra për kontrollin e ndikimeve dhe mbrojtjen e miedisit (performancë mjedisore);

◇ Vlerësuar përputhshmërinë me kërkesat e legjislacionit mjedisor për mbrojtjen e mjedisit.

Interpretimi i një gjendje të caktuar mjedisore duhet bërë në lidhje të ngushtë me fazën në të cilën gjendet zbatimi i projektit. Duhet kuptuar se nje gjendje e përqësuar e mjedisit në një fazë të caktuar të zbatimit e cila eshte fazë tranzitore nuk është tregues absolut i realizimit të objektivave të projektit.

Për zbatimin e masave të propozuara për mbrojtjen e mjedisit në secilën fazë të projektit, subjekti ka ngarkuar stafin drejtues i cili krahas punëve teknike do të bëjë dhe monitorimin e mjedisit.

Dëgjesa me publikun.

Subjekti D I A N I shpk, në zbatim te kuadrit ligjor vecanërisht për cështjen e konsultimit me publikun, ka organizuar një të tillë kohe me pare në kohën kur u pais fillimisht me leje mjedisi për aktivitetin e nxjerrjes së mineralit të kromit në objektin Theken Gal.nr.11dhe 23. Në këtë takim përveç banorëve të zones Martanesh dhe fshatrave të kësaj krahine, kanë marrë pjesë dhe përfaqësues të pushtetit vendor dhe përfaqësues të institucioneve rajonale mjedisore.

h) Konkluzione.

- ❖ Gjate zhvillimit te procesit te punes per te paksuar sasine e pluhurit ne miniere vendos shpimin e lagur.
- ❖ Perdorim te cakiceve shpues pneumatike me shume rrot/minut ne netoke me qellim shkurtimin e kohes se qendrimit te minatorit ne frontin e punes.
- ❖ Per nje siguri maksimale ne miniere jane siguruar mjetet e nevojshme te nderhyrjes ne raste avarishe.
- ❖ Niveli i zhurmave do te jete ne parametra normale dhe ne nivele te pranushme. Te gjitha makinerite jane te paisura me sistem mbrojtjes nga zhurmat
- ❖ Gjate zhvillimit te procesit te punes materialet inerte do te transportohen me mjete te pastra nga balta. Keshtu qe nuk do te kete rrjedhje apo shkarkime direkte ne mjedis te substancave te demshme.
- ❖ Kontrollohen shpesh kushtet teknike te mjeteve te punes dhe per te shmangur avarite,rrjedhjet e substancave te rezikshme ne mjedis dhe emetimet e zhurmave dhe gazeve
- ❖ Ujrat e zeza te objekteve ndihmese per punen ne miniere depozitohen ne gropa septike,te mbyllura duke bere te mundur nje impakt minimal ne mjedis.

Përgatiten raportin.

Ing. Gjeolg .Murat Cuka



Ing. Min.Hekuran MUCA